

21 Mars, 2023

Të Nderuar Prindër dhe Kujdestarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Po ju shkruajmë për t'ju informuar se **nxënësit e klasave 3-8 do të marrin pjesë në Sistemin e Vlerësimit të Shkollës së Pensilvanisë (PSSA) nga 24 Prill deri në 12 Maj 2023.**

PSSA është një mjet i rëndësishëm që ofron informacion kritik në lidhje me përparimin akademik të studentit(ve). Rezultatet individuale të studentëve i ndihmojnë mësuesit të identifikojnë pikat e forta dhe fushat e rritjes së fëmijës, gjë që i lejon mësuesit të personalizojnë udhëzimet e një fëmije për të mbështetur më së miri suksesin e tyre. Rezultatet e PSSA gjithashtu ofrojnë informacion për shkollat dhe drejtorinë për të mbështetur përmirësimin dhe planifikimin rreth kurrikulës dhe mësimdhënies.

PSSA është e mandatuara nga shteti dhe pjesëmarrja e të gjithë nxënësve në klasat 3-8 kërkohet me ligj federal. Çdo shkollë pritet të ketë të paktën 95% të nxënësve që marrin vlerësimet e “ English Language Arts”, Matematikës dhe Shkencës (për klasat 4 dhe 8). Nëse shkollat bien nën 95% të pjesëmarrjes, rezultati i performancës shtetërore për shkollën ndikohet negativisht. Gjatë periudhës së vlerësimit, është shumë e rëndësishme që nxënësit të ndjekin shkollën çdo ditë dhe të mbeten të regjistruar në shkollën e tyre aktuale. Për këtë arsye, kërkesat për transferime administrative do të shtyhen deri në fund të periudhës së vlerësimit, me përjashtime shumë të kufizuara.

Dokumentet e lidhura më poshtë ofrojnë informacion të rëndësishëm rreth PSSA-së së ardhshme. Ju lutemi rishikoni ato me kujdes. Ju gjithashtu duhet të merrni kopje të këtyre dokumenteve nga shkolla e fëmijës suaj dhe ato mund të gjenden në faqen tonë [PSSA website](#)

- [Udhëzuesi i Prindërve për PSSA /PSSA Parent Guide](#): Një përmbledhje e PSSA me lidhje me burimet për prindërit e drejtorisë .
- [Pyetjet e Bëra më Shpesh /Frequently Asked Questions](#):: Një fletë faktesh nga Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë që ofron përgjigje për pyetjet e bëra shpesh.
- [Karakteristikat dhe Akomodimet e Testit PSSA /PSSA Test Features and Accommodations](#): Një shpjegim i veçorive të testit dhe akomodimeve të disponueshme për studentët, duke përfshirë një lidhje me Udhëzimet e plota të Akomodimit.
- [Kodi i Sjelljes për Testuesit /Code of Conduct for Test Takers](#): Cfare duhet te bejne dhe çfare nuk duhet të bëjnë studentët gjatë testimit.
- [Pajisjet Elektronike Letra e Prindit /Electronic Devices Parent Letter](#): Një letër për familjet që detajon rregulloren e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë dhe pasojat për përdorimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike gjatë testimit.

Për informacion shtesë të Sistemit të Vlerësimit të Shkollës së Pensilvanisë (PSSA), ju lutemi vizitoni [faqen e internetit/website](#) të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë. Nëse keni pyetje

(Albanian)

të përgjithshme në lidhje me vlerësimet e drejtorisë, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Vlerësimit, Studimit dhe Përgjegjshmërisë [përmes formularit tonë të kontaktit/our contact form](#).

Sinqerisht,

Dr. Tonya Woford

*Shefe -Vlerësimit, Studimit dhe Përgjegjësisë*